



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja- Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture Development Agency

Bënë
SHPALLJEN BRENDSHME TË KONKURSIT

Për këtë vend pune:

Titulli i pozitës: Drejtor i Drejtorisë për Autorizimin e Pagesave

Ref: 07/04/01-159/2017

Njësia Organizative: Drejtoria për Autorizimin e Pagesave- AZHB

Vendi i punës: Prishtinë

Kategoria funksionale: Niveli Drejtues

Koeficienti: 10

Qëllimi i vendit të punës:

Menaxhon Drejtorinë përfshirë: organizimin, udhëzimin dhe koordinimin e punës, mbikëqyrje dhe kontrollë direkte të performancës, ndarjen e detyrave të punës për shërbyesit civil në Drejtori, ndihmon në formulimin e kriterëve për asistencë teknike dhe këshilla për punën e shërbyesve civilë brenda Drejtorisë si dhe ngritjen profesionale dhe disiplinën në punë për të punësuarit në Drejtori,

Përgatitë materialet dhe dokumentet që përfshijnë: planet e propozuara për punën në Drejtori dhe Sektorë, raporton për përparimin e arritur në zbatimin e programit në Drejtori, propozon politikën për çështjet kyçe që janë në kompetencën e Drejtorisë, mendime dhe analiza për çështjet që lidhen me politikën e caktuara dhe zbatimin e programit në punën e Agjencisë që kërkojnë vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë, iniciativat për adresimin e çështjeve problemeve individuale që janë nën kompetencat e Drejtorisë dhe,

Bashkëpunim i drejtpërdrejt me udhëheqësit e Sektorëve dhe trupat tjera nga autoritetet qeveritare për çështjet që janë kompetencë e Drejtorisë;

Detyrat kryesore:

1. Planifikimi dhe organizimi i punës ne Drejtori	25%
2. Zbaton dhe menaxhon kontrollet dhe raportet per punën ne DAP	10%
3. Inicion ndryshimin e akteve zyrtare, rregulloreve dhe akteve tjera	5%
4. Kujdeset për zbatimin e drejt të akteve ligjore	10%
5. Bashkëpunon me Ministrinë përgjegjëse, organizatat dhe Ministrinë tjera	10%
6. Koordinon punën dhe bashkëpunon me institucionet tjera qeveritare dhe njësit brenda AZHB-së	10%
7. Zbaton mbikëqyrjen e zgjeruar	5%
8. Siguron qe doracaket janë te harmonizuar ndërmjet veti dhe sipas legjislacionit	10%
9. Bashkëpunon me trupat tjera te kontrollit	5%
10. Kujdeset per zbatimin e drejt te punëve dhe per përmirësimin e vazhdueshëm	5%
11. Zbaton detyra tjera sipas instruksioneve nga Mbikëqyrësi	5%

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma Universitare: **Shkenca të Ekonomisë, Bujqësi;**
- Përvoja në punë: 6 vite përvojë pune profesionale - 3 vite në pozita drejtuese;
- Njohuri paraprake ne fushën e autorizimit te pagesave;
- Njohja e punës me kompjuter dhe aftësitë për të përdorur me efekt: Windowsin, World, Exel Access-in, dhe Microsoft Office;
- Fleksibilitet dhe aftësi për t'u përballë me situata të reja;
- Shkathtësi ne menaxhim, organizim, caktim te objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të gjuhës angleze.

Data e shpalljes së konkursit me: 22.06.2017

Data e mbylljes së konkursit: 29.06.2017

Te drejtë në konkurim kanë të gjithë zyrtarët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do te meren parasysh. Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e përzgjedhur do të informohen.

Dokumentet duhet te jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit në Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë - M B P Z H R , Ndërtesa e ish - Bankës së Lublanës Kati i VII , Zyra nr. 23.